FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 22

Tiranë – E hënë, 25 shkurt 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11079, datë 20.2.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	751
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 20.2.2019	Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2019, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil	751
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 20.2.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 446, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit".....	752
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 20.2.2019	Për ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me gradat e Policisë së Shtetit.....	752
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 82, datë 20.2.2019	Për rishpërndarje të numrit të punonjësve organikë dhe fondeve buxhetore, për vitin 2019, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme.....	753
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 20.2.2019	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, "Shkolla Finlandeze", Tiranë.....	753
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 84, datë 20.2.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 245, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës së koncerteve të Pallatit të Kongreseve, Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor", të ndryshuar.....	755
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë dhe Financave nr. 9, datë 20.2.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.....	755

Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të vdekur të shtetasit Bardhosh Tozaj..... 760

Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të zhdukur të shtetasit Veli Balla.... 760

Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Viktor Petroshi..... 760

Kërkesë për shpalljen të zhdukur ose të vdekur të shtetasit Demirali Qose..... 760

DEKRET
Nr. 11079, datë 20.2.2019

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare" të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Julka Zako Brajoviq (Matanoviç/Brojaj)
2. Zeliko Mehmet Ymeraj
3. Mohamed Fahed Ali Ymeraj
4. Snežana Millo Mikulić (Mikulic/Popoviq)
5. Vaso Branko Krstović (Krstovic/Nikolla)
6. Kens Kastriot Shurdhi
7. Taulant Myzafer Nuha
8. Oni Taulant Nuha
9. Alma Bajram Kimmlingen (Baja)
10. Artiola Flamur Zharri
11. Elvis Vasil Nasto
12. Vesna Biko Djinović (Djinovic/Nikaj/Vuciq)
13. Svetllana (Drita) Andrea Zllaticanin (Vaso/Kerstoja)
14. Biljana (Iljanë) Andro Stajkić (Stajkic/Stefoja)
15. Petar Millan Gjinoviq
16. Leme Shaban Ahmedi (Gjeta)
17. Senada Xhelal Kurtbegu
18. Dorela Bashkim Kruja (Scheffler)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir meta

VENDIM
Nr. 77, datë 20.2.2019

PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2019, NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2019, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, të jetë, gjithsej, 495 veta, i ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

a) Për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues 8;

b) Për kategorinë e mesme drejtuese 62;

c) Për kategorinë e ulët drejtuese 190;

ç) Për kategorinë ekzekutive 235.

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike;
- Audit i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;
- Histori-filologji;
- Shkenca mjekësore;
- Veterinari;
- Agronomi;
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
- Kimi;
- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Shkenca inxhinierike;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Artet e bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca ekzakte;
- Shkenca edukimi;
- Mësuesi;
- Arsim i lartë ushtarak/policor;
- Arsim i lartë.

3. Institucionet e administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2019 janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1
Lista e institucioneve të administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2019

1. Kryeministria dhe institucionet e saj të varësisë
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
3. Sistemi i Ministrisë së Brendshme
4. Ministria e Mbrojtjes
5. Sistemi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
6. Sistemi i Ministrisë së Drejtësisë
7. Sistemi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
8. Sistemi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
9. Sistemi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit
10. Sistemi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
11. Sistemi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë
12. Ministria e Kulturës

VENDIM
Nr. 78, datë 20.2.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 446, DATË 22.5.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PERSONELIT TË POLICISË SË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 19, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 446, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... 10 958 (dhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) punonjës ..." zëvendësohen me "... 11 058 (njëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e tetë) punonjës ...".

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 79, datë 20.2.2019

PËR EKUIVALENTIMIN E GRADAVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME GRADAT E POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 40/1, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr. 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me gradat e Policisë së Shtetit, sipas ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, sipas lidhjes nr. , që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr.1
Tabela ekuivalentuese e gradave ushtarake me gradat policore

Nr.	Emërtimet e gradave ushtarake sipas ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë"	Emërtimet e gradave të Policisë së Shtetit, sipas ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar
1	Kolonel	Drejtues i parë
2	Nënkolonel	Drejtues
3	Major	Kryekomisar
4	Kapiten	Komisar
5	Toger, nëntoger	Nënkomisar
6	Kryekapter, kapter	Inspektor i parë
7	Rreshter, tetar, nëntetar	Inspektor i dytë
8	Ushtar (IV, III, II I)	Inspektor

VENDIM
Nr. 82, datë 20.2.2019

PËR RISHPËRNDARJE TË NUMRIT TË PUNONJËSVE ORGANIKË DHE FONDEVE BUXHETORE, PËR VITIN 2019, NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES DHE MINISTRISË SË BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 e 18, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2019, shtohet me 100 (njëqind) punonjës për Policinë e Shtetit, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 14 249 (katërmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e nëntë) punonjës.

2. Numri i punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2019, reduktohet me 100 (njëqind) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 8 866 (tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) punonjës.

3. Në Ministrinë e Brendshme, në programin "Policia e Shtetit", shtohet fondi prej 61 000 000 (gjashtëdhjetë e një milionë) lekësh për shpenzime personeli, për vitin 2019.

4. Në Ministrinë e Mbrojtjes, në programin "Forcat e luftimit", reduktohet fondi prej 61 000 000 (gjashtëdhjetë e një milionë) lekësh për shpenzime personeli, për vitin 2019.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e lartpërmendura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2019.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 83, datë 20.2.2019

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT, PARAUNIVERSITAR, "SHKOLLA FINLANDEZE", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, "Shkolla Finlandeze", Tiranë, shoqërisë "Kolegji Indipendent", sh.p.k.

2. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, "Shkolla Finlandeze", Tiranë, do të ushtrojë veprimtarinë arsimore në adresën: Linzë, km 8, Tiranë.

3. Në institucionin arsimor privat, parauniversitar, "Shkolla Finlandeze", Tiranë, mësimi do të zhvillohet në gjuhë të huaj (në gjuhën angleze). Në lëndët si gjuhë shqipe, letërsi shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë, mësimi do të zhvillohet, detyrimisht, në gjuhën shqipe.

4. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, "Shkolla Finlandeze", Tiranë, do të ofrojë arsimim parauniversitar në nivelet:

a) arsim parashkollor;

b) arsim bazë.

5. Forma e arsimimit në institucionin arsimor privat, parauniversitar, "Shkolla Finlandeze", Tiranë, do të jetë arsimim me kohë të plotë.

6. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, "Shkolla Finlandeze", Tiranë, me fillimin dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij do të paraqesë në njësinë arsimore vendore, brenda afateve të përcaktuara, informacion për:

a) numrin e fëmijëve të kopshtit, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve të regjistruar, që do të fillojnë dhe do të mbarojnë vitin shkollor, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe statistikave të miratuara nga INSTAT-i;

b) planin mësimor, programet lëndore;

c) strukturën që do të ketë institucioni në fillim të çdo viti shkollor, e cila duhet të jetë e barasvlershme me atë të shkollave publike të të njëjtit nivel, së bashku me kalendarin e veprimtarive vjetore të institucionit;

ç) aktin e regjistrimit në organin tatimor;

d) lëndët mësimore të detyrueshme, njëlloj me ato të shkollave publike;

dh) listën e veprimtarive jashtëshkollore, që parashikohen të zhvillohen gjatë vitit shkollor;

e) adresën e institucionit, adresën elektronike (e-mail) dhe numrin e telefonit.

7. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, "Shkolla Finlandeze", Tiranë, duhet të miratojë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë çdo ndryshim në planin mësimor, programet e lëndëve apo tekstet që do të përdorë, si dhe çdo projekt apo eksperimentim psiko-padagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë, sipas rastit.

8. Ndryshimet që mund të pësojë institucioni arsimor privat, i licencuar, në vendndodhjen dhe infrastrukturën e godinës shqyrtohen dhe miratohen në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pas miratimit të njësisë arsimore vendore, 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës.

9. Institucioni arsimor privat, parauniversitar, "Shkolla Finlandeze", Tiranë, duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të nxënësve dhe të mësuesve;

b) Regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase, evidenca për lëvizjen e nxënësve (të detyrueshme për institucionin arsimor privat parauniversitar);

c) Rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit;

ç) Kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve;

d) Kontratat me prindërit për shërbimet arsimore apo shërbime të tjera, jashtëshkollore, që ofron;

dh) Kontratat e punës me mësuesit (për ata me kohë të plotë apo të pjesshme).

10. Dokumentacioni i paraqitur në pikat 6 e 9, në rast monitorimi dhe inspektimi, u vihet në dispozicion strukturave kompetente mbikëqyrëse.

11. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve si dhe mosdhënia apo fshehja e informacioneve nga strukturat kompetente mbikëqyrëse e inspektuese, të cilat do të verifikojnë apo do të kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtij institucioni arsimor, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

12. Në rast se institucioni arsimor privat nuk hapet gjatë dy viteve shkollore të njëpasnjëshme, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi, subjekti e humbet të drejtën e hapjes së institucionit.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, njësia arsimore vendore dhe institucioni arsimor privat, parauniversitar, "Shkolla Finlandeze", Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 84, datë 20.2.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 245, DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DHËNIEN ME QIRA, ME TARIFË TË REDUKTUAR, TË SALLËS SË KONCERTEVE TË PALLATIT TË KONGRESEVE, TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës së mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 245, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, viti "... 2018 ...", zëvendësohet me "... 2019 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 9, datë 20.2.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", I NDRYSHUAR

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

1. Në pikës 2.3.1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjalia "Shënim. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. Vlera e taksës është për vitin kalendarik në të cilin arkëtohet, me vlefshmëri 365 ditë, pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet", zëvendësohet me:

"Shënim. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. Detyrimi i taksës paguhet për vitin kalendarik (nga 1 janari deri më 31 dhjetor) për të cilin ka lindur detyrimi. Taksa e paguar në vitin aktual, pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet, ka vlefshmëri 365 ditë.

Shembull: Pronari i mjetit paraqitet me datë 11.2.2019 për të paguar taksën e vitit 2019, pra detyrimin e taksës për periudhën nga 1.1.2019 deri më 31.12.2019. Afati i vlefshmërisë së kësaj takse është deri me 11.2.2020".

b) pas fjalive me përmbajtjen: "Mjetet që regjistrohen për herë të parë, në momentin e targimit të tyre, paguajnë taksën vjetore të mjeteve të përdorura (TVMP)…….. pavarësisht datës së muajit", shtohet fjalia"

"Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, por që në momentin e targimit kërkohet të bëhet njëkohësisht edhe procedura e çregjistrimit të përkohshëm të tyre, detyrimet për TVMP llogariten dhe paguhen për muajin në të cilin mjeti do të regjistrohet, ndërkohë që bëhet edhe procedura e çregjistrimit të tij, duke dorëzuar targat dhe lejen e qarkullimi".

2. Në pikën 2.4, para paragrafit të fundit, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

Për sasitë e benzinës dhe të gazoilit të prodhuar në vend, por të eksportuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë taksa nuk paguhet. Subjektet prodhuese dërgojnë informacion pranë DPT-së, brenda datës 15 të muajit pasardhës, për të cilin bëhet deklarimi dhe pagesa e taksës, të dhëna mbi sasinë e gazoilit dhe benzinës të prodhuar, sasitë e eksportuara, si dhe sasitë për të cilat paguhet taksa.

3. Ne pikën 2.5.1, në paragrafin e fundit, togfjalëshi "në masën sa 1/2 e normës së rentës" zëvendësohet me "në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2021 e në vijim".

4. Në pikën 2.5.2, në paragrafin e dytë, togfjalëshi "në masën sa 1/2 e normës së rentës" zëvendësohet me "në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për

vitin 2020 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2021 e në vijim"

5. Pas pikës 2.7, shtohet pika 2.8, me përmbajtjen, si vijon:

2.8 Taksa e materialeve/artikujve plastikë, lëndëve të para të importuara për prodhimin e tyre dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi.

Pikat 2.8.1 deri 2.8.8, ndryshohen me përmbajtjen, si vijon:

2.8.1 Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve plastike që importohen dhe bëjnë pjesë në kapitullin 39 të NKM-së, është 35 lekë/kg. Nuk e paguajnë këtë taksë 35 lekë/kg, lëndët e para në forma primare që importohen sipas krerëve 3901 deri në 3914, të NKM-së.

Përveç materialeve/artikujve të importuar në kapitullin 39 të NKM-së, kjo taksë zbatohet edhe kur materiali plastik zë, të paktën, 51 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të importuara, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Në rastet kur në materialet/artikujt që importohen në kapitullin 39 të NKM-së, pjesa joplastike zë më shumë se 51 për qind të masës së përgjithshme, kjo taksë zbatohet vetëm për pjesën e masës së plastikës (si p.sh., dyer, dritare etj...).

2.8.2 Taksa e lëndëve të para në forma primare të importuara, që klasifikohen në krerët 3901 deri në 3914 të NKM-së, dhe që përdoren për prodhimin në vend të produkteve të plastikës është 25 lekë/kg.

2.8.3 Taksa e ambalazheve prej qelqi është 5 lekë/kg dhe zbatohet për ambalazhet prej qelqi të importuara e të prodhuara në vend. Taksa zbatohet për të gjithë artikujt prej qelqi, sipas kreut 7010 të NKM-së, në rast se ambalazhi importohet veçmas si dhe kur materiali i qelqit zë, të paktën, 80 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

2.8.4 Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e taksës:

Administrata Doganore është përgjegjëse për mbledhjen e:

a) Taksës së materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve plastike të importuara;

b) Taksës së lëndëve të para në forma primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së, dhe që përdoren për prodhimin në vend të produkteve të plastikës;

c) Taksës së ambalazheve prej qelqi të importuara;

Administrata Tatimore është përgjegjëse për mbledhjen e:

d) Taksës së ambalazheve prej qelqi të prodhuara në vend.

2.8.5 Pagesa dhe transferimi në llogarinë e të ardhurave tatimore të taksës.

Pagesa e taksës nga importuesi sipas pikave "a"; "b" dhe "c", të paragrafit 2.8.4 më lart, bëhet në momentin e importit të tyre, para se këto mallra të jenë liruar për qarkullim të lire.

Pagesa e taksës nga prodhuesi vendas sipas pikës "d"; të paragrafit 2.8.4 më lart, bëhet së bashku me dorëzimin e deklaratës së taksave kombëtare, brenda datës 15 të muajit pasardhës për muajin paraardhës.

Transferimi nga Administrata Doganore e të ardhurave të arkëtuara nga taksa, në llogarinë e të ardhurave të Administratës Tatimore bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës për muajin paraardhës.

2.8.6 Procedurat e deklarimit në import dhe pagimit të taksës për ambalazhet plastike dhe/ose qelqi

i. Për qëllime të aplikimit të taksës për ambalazhin plastik/qelqi të importuar, subjekti importues, vetë, apo nëpërmjet kompanisë prodhuese apo eksportuese, bën ndarjen e llojeve të ambalazhit të produkteve të importuara. Deklarimi i ambalazhit në DAV në import bëhet në nivel artikulli. Kur për të njëjtin artikull ka ambalazhe të ndryshme, sipas kategorizimit plastikë apo qelq, detyrimisht në DAV, për artikujt me kod tarifor të njëjtë, do të bëhet deklarimi i ndarë (me BIS), por me kod të ndryshëm ambalazhi (kutia 31 e DAV).

ii. Në llogaritjen e taksës për ambalazhin plastik, nga pesha bruto, do të zbritet pesha e paletave transportuese të drurit, të kartonit apo atyre metalike.

Shembuj:

a) Në rast se importuesi deklaron ambalazh plastik sipas kodeve tarifore nga kreu 3916 deri 3926 të NKM-së, taksa do të llogaritet mbi bazën e peshës neto, duke aplikuar nivel taksimi 35 lekë/kg;

b) Në rast se importuesi deklaron mallra në ambalazh qelqi, sipas kodeve tarifore të kreut 7010

të NK-së, taksa do të llogaritet mbi bazën e peshës neto, duke aplikuar nivel taksimi 5 lekë/kg;

c) Në rast se importuesi deklaron mallra të klasifikuara në kode të tjera tarifore të NKM-së, në kutinë 31 të DAV, përdoret kodi përkatës i ambalazhit plastik dhe taksa zbatohet mbi diferencën e peshës bruto me atë neto, duke aplikuar nivel taksimi 35 lekë/kg. Në kutinë 38 të DAV, si peshë neto plotësohet pesha e produktit të konsumueshëm pa asnjë lloj ambalazhi;

d) Në rast se importuesi deklaron mallra të klasifikuara në kode tarifore të tjera të NKM-së, në kutinë 31 të DAV përdoret kodi përkatës i ambalazhit të qelqit, dhe taksa zbatohet mbi diferencën e peshës bruto me atë neto, duke aplikuar nivel taksimi 5 lekë/kg. Në kutinë 38 të DAV si peshë neto plotësohet pesha e produktit të konsumueshëm pa asnjë lloj ambalazhi;

e) Në rast se importuesi deklaron se në të njëjtën ngarkesë, ndodhen mallra që janë të klasifikuara në krerët 3923 dhe 7010 të NKM-së (edhe ambalazh plastik bosh, edhe ambalazh qelqi bosh), atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (me BIS) dhe llogaritja e taksës për çdo artikull bëhet për diferencën e peshës bruto me atë neto;

f) Në rast se importuesi deklaron, se në të njëjtën ngarkesë, paraqiten mallra që janë të paketuara në ambalazh plastik dhe qelqi (p.sh. vaj vegjetal i ambalazhuar një pjesë në shishe plastike dhe një pjesë në shishe qelqi), atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (me BIS), duke përdorur kode të ndryshme ambalazhi për sasitë respektive. Llogaritja e taksës për çdo artikull bëhet për diferencën e peshës bruto me atë neto;

g) Në rast se importuesi deklaron produkteve gjysmë të gatshme (p.sh. pipeta), të cilat destinohen për prodhimin e ambalazheve të plastikës apo të qelqit, taksa llogaritet dhe paguhet në import, para çlirimit për qarkullim të lirë, pavarësisht nëse importuesi i importon këto produkte në funksion të aktivitetit të vet prodhues apo është importues i këtyre produkteve për qëllime tregtare.

2.8.7 Procedura e deklarimit të ambalazheve të qelqit nga prodhuesit vendas

Për ambalazhet prej qelqi të prodhuara në vend, taksa përfshihet në vlerën e tatueshme të faturës, para se të aplikohet TVSH-ja. Subjekti prodhues i ndan në faturën tatimore artikujt sipas kapacitetit mbajtës të ambalazhit.

Në rastet kur subjektet prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh qelqi, e prodhojnë vetë ambalazhin dhe e shesin atë edhe për të tretë, paguajnë taksën për sasinë e shitur të ambalazhit me faturë tatimore, si dhe për sasinë e përdorur të ambalazhit për nevojat e ambalazhimit të produkteve të tyre.

2.8.8 Procedura e kontrollit të lëndëve të para në forma primare të importuara në krerët 3901 deri në 3914 të NKM-së, në rastet kur nuk përdoren për prodhimin në vend të produkteve të plastikës.

2.8.8.1 Taksa 25 lekë/kg për lëndët e para në forma primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së, zbatohet për të gjithë prodhuesit/importuesit që e përdorin për prodhimin në vend të produkteve të plastikës.

Taksa për lëndët e para në forma primare të importuara nga subjektet prodhuese, që kategorizohen në krerët 3901 deri në 3914, do të aplikohet vetëm nëse produktet e prodhuara nga këto lëndë të para të importuara janë subjekt i llogaritjes së taksës në import.

Në rastet kur lëndët e para në forma primare, të importuara nga subjektet prodhuese dhe që klasifikohen në krerët 3901 deri në 3914, nuk përdoren për prodhimin e produkteve të plastikës në vend, por si plotësues teknologjik, lëndë të para additive (agregate lidhës) për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si produkte plastike, taksa 25 lekë/kg nuk paguhet në import. Ky përcaktim zbatohet dhe për rastet kur lëndët e para në forma primare, të importuara nga subjektet prodhuese në krerët 3901 deri në 3914, përdoren për prodhimin e materialeve plotësuese për prodhues të tjerë, produktet finale të të cilëve nuk përfshihen në kapitullin 39 të NKM-së.

Shembuj:

a) Lëndët e para të llojit, si p.sh.: Vinnapas (NKM 3905), Culminal (NKM 3912), Ëalocel (NKM 3912) etj., të cilat importohen direkt nga prodhuesit vendas i materialeve të ndërtimit, apo të prodhimit të çdo lloj artikulli tjetër që nuk përfshihet në kapitullin 39 të NKM, si p.sh.: llaç, fino, grafiato, kollë etj., dhe që përdoren në procesin teknologjik me qëllim fleksibilitetin e materialit, lidhjen e lëndëve të para, ngjitjen e tyre etj. Në këtë rast materialet e ndërtimit apo artikujt e tjerë të prodhuara nuk konsiderohen produkte të plastikës, prandaj për to nuk paguhet taksa.

b) Lëndët e para të importuara direkt nga prodhuesit vendas, me qëllim prodhimin e produkteve që përdoren në industrinë e ndërtimit.

c) Lëndët e para të importuara direkt nga prodhuesit vendas, me qëllim prodhimin e produkteve që janë materiale dhe lëndë të para për industrinë e prodhimit të mobilieve, si p.sh., poliolet (NKM 3907-3909) që përdoren për prodhimin e sfungjerit, i cili përdoret në fushën e mobilierisë, ku produktet finale janë të kategorizuara jashtë kapitullit 39, si p.sh., "karrige", "kolltukë" etj.

2.8.8.2 Subjektet importuese, të cilat përdorin lëndë të parë, apo material ndihmës importi të kategorizuar në kodet 3901 deri në 3914, të NKM-së, por që janë prodhues të mallrave/materialeve që nuk kategorizohen ne grupin e produkteve të plastikës, ose që produktet apo materialet ndihmëse të tyre, përdoren për prodhimin e materialeve plotësuese për prodhues të tjerë, produktet finale të të cilëve nuk përfshihen në kapitullin 39 në NKM-së, depozitojnë në Drejtorinë Rajonale Tatimore për përjashtimin e taksës 25 lekë/kg në import dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Licencë/leje/miratim nga institucioni përkatës i autorizuar (nëse kërkohet nga legjislacioni), për prodhimin e produktevejo plastike, por që përdorin edhe lëndë ndihmëse që kategorizohen në kodet 3901 deri në 3914, të NKM-së.

b) Listën e detajuar të mallrave dhe materialeve që prodhon, përfshirë edhe kodin e tyre në rastet kur këto mallra apo materiale importohen.

c) Kartën teknologjike të procesit të prodhimit ku përcaktohen sasitë e materialeve që kategorizohen në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së të nevojshme për prodhimin e produkteve joplastike.

d) Për rastet kur produktet/materialet janë materiale plotësuese për prodhues të tjerë produktesh finale, të cilat nuk përfshihen në kapitullin 39 në NKM-së, dokumente të tilla si kontratat, apo porositë me blerësin e këtyre materialeve plotësuese, si p.sh., me një prodhues mobiliesh.

e) Nevojat tremujore dhe vjetore të importit të materialeve që kategorizohen në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së, të nevojshme për procesin teknologjik.

f) Të dhënat tremujore dhe vjetore të produkteve jo plastike të prodhuara dhe për të cilat janë përdorur materiale të importuara në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së.

g) Gjendja e inventarit tremujor dhe në fund të vitit e materialeve të importuara për qëllime prodhimi, në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së.

Subjektet importues të pajisur me autorizim nga Drejtoria Rajonale Tatimore për mospagesën e taksës për importimin nga vetë prodhuesi për qëllime prodhimi të mallrave joplastike, të materialeve sipas kodeve 3901 deri në 3914 të NKM-së, që kanë bërë pagesën nga data 1 janar 2019 deri në datën e publikimit në Fletoren Zyrtare të këtij udhëzimi, rimbursohen nga Dega Doganore ku ka kryer importin. Procedura e rimbursimit bëhet *mutatis-mutandis* sipas pikës 2.8.9.

2.8.8.3. Drejtoria Rajonale Tatimore:

a) krijon dosje për çdo importues që prodhon vetëprodukte jo plastike apo materiale plotësuese për një kategori tjetër prodhimi qe prodhon produkte jo plastike, duke përdorur edhe materialeve të importuara nga ai vetë për qëllime prodhimi, në kodet 3901 deri në 3914 të NKM-së;

b) dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

i. kopje të dosjes për subjektin importues i cili prodhon mallra dhe materiale joplastike;

ii. autorizimin me shkrim për mospagesën e taksës për importimin nga vetë prodhuesi për qëllime prodhimi të mallrave joplastike, të materialeve sipas kodeve 3901 deri në 3914 të NKM-së;

iii. revokimin anulimin apo ndryshimin e autorizimit kur konstaton se importet e materialeve sipas kodeve 3901 deri në 3914 të NKM-së nuk janë përdorur për prodhimin e mallrave joplastikë.

c) monitoron dhe kontrollon përdorimin e materialeve sipas kodeve 3901 deri në 3914 të NKM-së, për të cilat taksa nuk është paguar.

7. Pas pikës 2.8.8, shtohet pika 2.8.9., me përmbajtjen, si vijon:

2.8.9 Rimbursimi i taksës në rastet e eksportit

Për ambalazhet plastike/qelqi të cilat eksportohen, dhe për të cilat taksa është paguar në momentin e importit/prodhimit të tyre, bëhet rimbursimi i saj. Administrata Doganore rimburson taksën për sasinë e eksportuar të ambalazhit si më vijon:

a) Në rast se eksportuesi është importues dhe/ose prodhues vendas dhe ka paguar në import taksën e ambalazheve prej plastike/qelqi në momentin e importit, Administrata Doganore rimburson për të gjithë sasinë e eksportuar të ambalazhit sipas nivelit të taksimit.

b) Rimbursimi behet edhe për subjektet eksportuese të cilët janë furnizuar me ambalazhe prej plastike/qelqi nga importues vendas, të cilët e kanë paguar taksën e këtyre ambalazheve në momentin e importit.

Në rast se eksportuesi është prodhues vendas dhe ka paguar në import taksën e lëndëve të para në forma primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së, e cila përdoret për prodhimin në vend të produkteve të plastikës, Administrata Doganore rimburson në masën respektive të lëndës së parë të përdorur për të gjithë sasinë e ambalazhit që eksportohet sipas nivelit të taksimit.

Rimbursimi për taksën e paguar për lëndët e para bëhet edhe për subjektet eksportuese të cilët janë furnizuar me ambalazhe prej plastike nga prodhues vendas që e kanë paguar këtë taksë në momentin e importit.

c) Administrata Doganore bën rimbursimin e taksës duke përdorur të ardhurat e arkëtuara nga kjo taksë në muajin korrent kur bëhet rimbursimi. Në muajin pasardhës, Administrata Doganore transferon taksën e arkëtuar në llogarinë e Administratës Tatimore, duke sqaruar shumën bruto të arkëtuar në muajin paraardhës, rimbursimin e kryer për sasinë e eksportuar, si dhe shumën neto të transferuar.

2.8.9.1 Rimbursimi i taksës mund të bëhet kundrejt plotësimit të aplikimit dhe marrjes së vendimit, sipas aneksit 33–07, shtojcat A dhe B, të VKM nr. 651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

Aplikimi i drejtohet zyrës doganore mbikëqyrëse dhe duhet të përmbajë:

a) llojin e aktivitetit;

b) llojin e mallit;

c) shumën për të cilën kërkohet rimbursim;

d) arsyet e kërkimit të rimbursimit;

e) nivelin e taksimit të zbatuar në momentin e pagesës;

f) destinacionin e mallit;

g) mënyrën e identifikimit të mallrave;

h) dokumentacionin respektiv me të cilin është kryer pagesa e taksës (DAV, faturë tatimore etj.).

i) kur është rasti, masën respektive të lëndës së parë të përdorur për të gjithë sasinë e ambalazhit që eksportohet, sipas kartës teknologjike të depozituar në Drejtorinë Rajonale Tatimore.

2.8.9.2 Aplikimit për rimbursim i bashkëngjitet dokumentacioni për produktin, për të cilin kërkohet rimbursimi i taksës dhe pagesat që janë kryer për produktin, objekt rimbursimi. Rimbursimi i taksës mund të kërkohet deri në 1 vit nga data e pagesës së taksës në import.

8. Në pikën 2.11.2, pas fjalive me përmbajtjen: "Mjetet që regjistrohen për herë të parë, në momentin e targimit të tyre, paguajnë taksën e përvitshme për automjetet luksoze në raport me kohën e hyrjes në qarkullim në territorin e Shqipërisë. Në rast se mjeti regjistrohet në muajin janar, TVML-ja paguhet e plotë, ndërsa për periudhën në vazhdim në raport me muajt e hyrjes në qarkullim, pavarësisht datës së muajit." shtohen:

"Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, por që në momentin e targimit kërkohet të bëhet njëkohësisht edhe procedura e çregjistrimit të përkohshëm të tyre, detyrimet për TVML llogariten dhe paguhen për muajin në të cilin mjeti do të regjistrohet, ndërkohë që bëhet edhe procedura e çregjistrimit të tij, duke dorëzuar targat dhe lejen e qarkullimi".

Shembull: Subjekti/qytetari, paraqitet në DRSHTRR për të regjistruar mjetin me cilindratë 3628 cm^3, lloji i karburantit naftë, vit prodhimi 2008, por njëkohësisht kërkon të bëjë çregjistrimin e përkohshëm për këtë mjet. Për mjetin në fjalë, punonjësi i DRSHTRR do të bëjë regjistrimin sipas procedurave përkatëse, do llogarisë dhe arkëtojë për një muaj TVMP-në në shumën 1.058 lekë, TRML-në do ta llogarisë dhe arkëtojë të plotë, si dhe do të llogarisë dhe arkëtojë TVML-në për një muaj në shumën 1.750 lekë. Njëkohësisht do të mbahen targat dhe leja e qarkullimi për këtë mjet sipas procedurave përkatëse. Kur subjekti/qytetari pronar i mjetit do të paraqitet pranë DRSHTRR-së për të rikthyer në qarkullim mjetin, p.sh., në datën 12.07.2019, nga ana e punonjësit përkatës do të llogaritet dhe arkëtohet diferenca e TVMP-së për 6 muaj, korrik dhjetor 2019, në shumën 6.348 lekë dhe TVML-së për 6 muaj korrik–dhjetor 2019 në shumën 10.500 lekë, si dhe do të bëhet rikthimi në qarkullim i këtij mjeti sipas procedurave të

përcaktuara.

9. Në shkronjën "dh", të pikës 3.1 "Përjashtohen nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura", pas fjalëve "Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK)" shtohet "ose Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit".

10. Në paragrafin 4.2, të pikës 3 "Përjashtime nga taksat kombëtare" bëhen ndryshimet si vijon:

a) Paragrafi i parë me përmbajtjen "Përjashtohen nga pagimi i taksës së ambalazheve të plastikës dhe të qelqit:" riformulohet si vijon:

"Përjashtohen nga pagesa e taksës së materialeve/artikujve plastike dhe ambalazheve prej plastike/qelqi:"

b) Nënparagrafët: "i", "ii", "iii", "iv", "vi", "vii", të shkronjës "ç", shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2019.

MINISTRI I EKONOMISË
DHE FINANCAVE
Anila Denaj

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1491, datë 24.9.2018, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Bardhosh Tozaj, i datëlindjes 14.6.1960, në datën 31.8.1990.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1997, datë 3.12.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Veli Balla, i datëlindjes 27.10.1968.

KËRKESË

Shtetasi Kostandin Petroshi kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shpalljen të zhdukur të shtetasit Viktor Petroshi, i datëlindjes 14.1.1988, si dhe caktimin e kërkuesit si kujdestar të administrimit të pasurisë së tij.

KËRKUES
Kostandin Petroshi

KËRKESË

Shtetasi Ilger Qose kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shpalljen të zhdukur ose të vdekur të shtetasit Demirali Refat Qose, i datëlindjes 20.10.1947.

KËRKUES
Ilger Qose

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë